

Data 22.09.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Zgjerim rrjeti 20 kV, Ndertim kabine elektrike dhe ndertim rrjeti T.U per zonen e Nikles N/St 110/20 kV Fushe Kruje”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45231400-9 - Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT: 71,892,508.02 (shtatedhjete e nje milion e teteqind e nentedhjete e dy mije e peseqind e tete pike zero dy) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikes 1 te shtojces 8, ofertuesi duhet te deklaroje se permbush kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit. Keto kriteret duhet te plotesohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, ne ditën e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2022, 2023 dhe 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:...b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: “Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”.

Ky kriter siguron që operatorët ekonomikë që marrin pjesë kanë kapacitetin financiar për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë të sigurtë dhe të efektshme. Ky është i rëndësishëm për të shmangur situata ku operatorët nuk plotesojnë kapacitetin financiar dhe nuk mund të përfundojnë projektin.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024**, të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga

veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar*, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Bashkitë) për shlyerjen e taksave vendore **per vitin e fundit** të maturuar 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

*** Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/et lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në Shtojcën përkatëse të DST.

Argumentimi: Ne lidhje me kërkesen për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Njësia e prokurimit kërkoj edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriterë janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
1. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të **deklaruar në organet tatimore** dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.
 - Aktin e kolaudit;

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, sipas parashikimeve të *nenit 88, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar Pika 2.3.1 gërma "a" plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse *pika 2.3.1 gërma "b"* duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (*Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar*).

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, sipas parashikimeve të *nenit 88, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar Pika 2.3.1 gërma "a" plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë

të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse *pika 2.3.1 gërma “b”* duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (*Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar*).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat. **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **200%**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përmirësimi i infrastrukturës së linjave TM/TU kërkon një kohë të konsiderueshme për të kryer punët me sukses dhe në përputhje me standardet e nevojshme. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje.

Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur.

Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi*” të ndryshuar, e cila përfshin kategorite e mëposhtme:

Punime të përgjithshme/speciale ndertimi:

Kategoria NP-1	Punime germimi në toke	Klasifikimi A
Kategoria NP-11	Ndertime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesme dhe shpërndarjen e energjisë	Klasifikimi C
Kategoria NS-8	Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	Klasifikimi A

Shenim: Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehesimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet:

*“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”*

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kodi	Emertimi	Vlera me Tvsh	Nr.
NP - 1	Punime germimi ne toke	8,203,803.51	A
Zerat e punes	Hedhje,rafshim,mbushje dheu me krah, Germim kanalesh, Germim dheu per gropa shtyllash , Germim dheu me ekskavator, Prishje shtrese çakelli, Shtrese tulla / pllaka, Mbushje, rafshim,ngjeshje, etj.		

NP - 11	Ndertime per N / Stacionet, kabinat e transformatoreve, linjat e TN e te TM dhe shperndarjers se energjise	70,860,748.86	C
Zerat e punes	Montim / Demontim Transformatori, Box, Panele TU, Siguresa, Shkarkues, Ndares, Çela, Shtrirje kabje te ndryshem, Montim / Demontim shtylla, dhe çdo elementi tjetër te nevojshem per ndertimin e linjes dhe kabinave, etj.		
NS - 8	Ndertime parafabrikat, beton arme, struktura metalike dhe druri	4,365,284.77	A
Zerat e punes	Pllaka, mure, shtrese betoni, struktura monolite te ndryshme, F.V. hekur periodik, etj.		

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Elektrik
 - b. 1(nje) Inxhinier Ndërtimi
- Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin teknik te punimeve ne objekt, i cili duhet të jete përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik dhe të deklaroje se nuk eshte i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jete i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figuroje në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune (Drejtuesin teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kriteri i punësimit të një inxhinieri elektrik dhe një inxhinieri ndertimi si drejtues teknik me licencë është i rëndësishëm për disa arsye. Me qëllim ndërtimin e objektit të veprës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Vendosja e një inxhinieri elektrik dhe një inxhinieri ndertimi si drejtues teknik siguron që puna do të kryhet në përputhje me standardet teknike dhe me kujdesin e duhur për sigurinë e punonjësve dhe të mjedisit. Ky kriter ndihmon në garantimin e cilësisë së punëve. Inxhinieri elektrik si drejtues teknik është përgjegjës për monitorimin e punimeve dhe menaxhimin e situatave teknike që mund të dalin gjatë zbatimit. Kërkesa për të siguruar që inxhinieri elektrik është i regjistruar dhe i siguruar në listat e pagesave të sigurimeve për një periudhë të caktuar siguron se operatori ekonomik respekton të gjitha detyrimet legjislative dhe siguron që punonjësit janë të mbrojtur në rast të ndonjë aksidenti ose dëmtimi. Është kërkuar të kete në staf Inxhinier Ndërtimi, i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit të punimeve për anën ndertimore kryesisht për ndërtimin e bazamentit të kabines box, ndërtimin e bazamentit të shtyllave të betonit, për punime civile, rikthimin në gjendjen e mëparshme të rruges dhe përcaktimin e shtresave përberese të saj etj.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e duhur për të dëshmuar që ka përmbushur këtë kriter. Ky dokumentacion përfshin kontratën individuale të punës, diplomën e inxhinierave, CV, librezë pune dhe liste pagesa.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të kete minimumi 7 (shtatë) elektrikistë, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik minimumi me grupi II të vlefshme, nga të cilët:

- minimumi 2(dy) te jene elektriciste me grupin e sigurimit teknik IV te vlefshme, te leshuar nga shoqeri te akredituara ne baze te Ligjit Nr. 8734, date 01.02.2001 “Per garantimin e sigurise se punes te pajisjeve dhe te instalimeve elektrike”, i ndryshuar.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Listpagesat e punonjesve te sipercituar te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per **muajin** e fundit te deklaruar, si dhe
- Kartelat perkatese te vlefshme te sigurimit teknik.

a. 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" i ndryshuar.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata e cituar më sipër, kontratë pune e vlefshme, Librezë pune
- b. te pakten 3 (tre) manovratore te pajisur me karte personale te sigurimit teknik, te leshuar nga organet kompetente, te cilet duhet te jene te siguruar te pakten per muajin e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates (nese automjetet jane ne pronesi te OE ofertues).

Ne rastin kur automjetet merren me qira, manovratoret e pajisur me karte personale te sigurimit teknik, mund te kontraktohen nga OE ofertues per realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi.

Ne lidhje me manovratorin e makinerive te renda te paraqiten deshmite e drejtimit te leshuar nga organet perkatese.

c. te pakten 2 (dy) shofere

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme, *Deshmi Aftesie Profesionale te vlefshme (leshuar nga institucionet perkatese)*, Librezë pune .

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të

dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

Argumentimi: Kërkesa është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Per kerkesen per specialiste elektriciste, njesia e prokurimit eshte bazuar ne punimet elektrike qe do behen sipas zerave perkates te preventivit.(referoju tabelas se meposhteme).

a) Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

b)Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Konkretisht:

Argumentim i detajuar per numrin e punonjesve

1. Punimet elektrike.

Bazuar ne zerat e preventivit dhe sipas oreve te punes nxjerre nga manuali i e-albania per punimet elektrike rezulton se ne total punime elektike ne te cilat nevojitet nderhyrja dhe puna e personelit te specializuar elektiçiste, rezulton se per periudhen 9 mujore ne te cilen ky objekt duhet te perfundoje, jane ne total 10 595.03 ore pune elektike per te cilat nevojiten 7 elektriçiste nga te cilet

2 duhet te jene me grupin 4 ST te sigurimit duke qene se procese te punes te tilla psh: Montim kabine Box, shkarkuesi, çele, kabell ABC, terminali, mufte, etj procese specifike ku duhet nje nderhyrje e specializuar.

2. Punime dhe germime me krahe.

Bazuar ne zerat e preventivit dhe sipas oreve te punes nxjerre nga manuali i e-albanias per punime germimi apo te ndryshme me krahe, rezulton se ne total punime per te cilat nevojitet puna e nje personelit te pa specializuar (punetore krahu), rezulton se per periudhen 9 mujore ne te cilen ky objekt duhet te perfundoje jane ne total 2 714.42 ore pune punime + germime me krahe, per te cilet duhen 2 punetore te pa specializuar.

3. Manovratore.

Po keshtu ne zerat e preventivit dhe sipas oreve te punes nxjerre nga manuali i e-albanias per Punime me makineri germimi dhe shtrimi , rezulton se punime te tilla per periudhen 9 mujore ne te cilen ky objekt duhet te perfundoje jane ne total 3 827.92 ore pune, per te cilat duhen 2 mjete te tipit Eskavator.

3.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 16** (gjashtembedhjete) **persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- c) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **muajin** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- d) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per **muajin** e fundit te deklaruar.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të*

dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;**

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit si dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit duke përfshirë ketu numrin total të punonjësve (inxhinierë, teknike, specialiste, punonjës të kualifikuar dhe punetore për punime me krahe, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të renda etj).

Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te jane bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport).Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

3.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet/ makineri dhe pajisje	Sasia
1	Eskavator me goma(makineri shtrimi&germimi)	2 cope
2	Kenotron kablli	1 cope
3	Tokmak elektrik	1 cope
4	Betoniere (kantieri)	2 cope
5	Prerese asfalti & betoni	1 cope
6	Auto – vinç min 5-10 ton	2 cope
7	Autovinc min 16 ton	1 cope
8	Vinc kulle 0,5-1 ton	1 cope

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton pronesine e mjetit (certifikate pronesie), dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi); te vlefshme. Per mjetet e siguruara me qera, te paraqiten dokumentet qe vertetojne rregjistrimin e tij, plus certifikaten e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit te vlefshme. Keto dokumente duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerase te vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes / fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit.

Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Per pajisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt shoqeruar me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesemarres duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesemarres duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpyesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e

asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Ne kërkesat e NjP ne kemi kerkuar qe operatorët ekonomikë pjesëmarrës te kete dhe minimum makineri & pajisje si me poshte, bazuar keto ne zerat e preventivit si dhe ne manualin e-albania:

Argumentimet teknike te detajuar per makineri & pajisje.

1. Tokmak elektrik (1 nje)

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 3.47 / 1b (*Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme*).

2. Betoniere (2 dy)

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 2.262 / 3 (*Shtrese betoni C 12/15*).

3. Tokmak elektrik (1 nje)

Perdoret per ngjeshjen e shtresave te ndryshme si dhe te binderit e asfaltobetonit.

4. Prerese Asfalti (1 nje)

Kerkohet ne preventive dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 4.19

5. Kenotron kablli (1 nje)

Kerkohet ne preventive dhe ne manualin e-albania sepse perdoret per kontrollin perfundimtar te linjave te shtruara te kabujve dhe te izolacioneve.

6. Mjete transporti vetshkarkuese auto vinç 5 – 10 ton (2 dy)

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 2.37 / 5b (*Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km*).

7. Vinç kulle 0.5 - 1 ton (1 nje)

Kerkohet ne preventive dhe ne manualin e-albania sepse perdoret per kompletimin e shtyllave me elementet perkates si dhe ne procese te tjera ne lartesi.

8. Auto - vinç 16 ton (1 nje)

Kerkohet ne preventive dhe ne manualin e-albania sepse perdoret per ngritjen dhe vendosjen e Kabines box parafabrikat 11+1t.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **9 (nente)** muaj kalendarike.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçense te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kusht duhet te plotesohet nga operatori ekonomik i cili ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet kjo licence.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, I ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës

Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”. Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi.

Kërkesa për liçencën siguron që punët do të kryhen në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore. Liçenca është e rëndësishme për të garantuar që operatori ekonomik do të menaxhojë mbetjet në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme. Kjo përfshin grumbullimin, transportimin dhe eliminimin e mbetjeve në mënyrë që të minimizohet ndikimi negativ mbi mjedisin dhe shëndetin e njerëzve.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat perkatese të vlefshme të ISO-ve, të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si me poshte:

ISO 9001: 2015 për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente (të vlefshme)

ISO 14001: 2015 për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ose ekuivalente (të vlefshme)

ISO 45001: 2023 për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë ose ekuivalente (të vlefshme)

*** Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë certifikatën ISO në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të Ligjit 162/2020 të Prokurimit Publik, parashikohet se

autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Konkretisht:

- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE I interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mire të cilësisë.
- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 45001:2023 ose ekuivalent, është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, AK duhet të sigurohet se OE zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Paisja me këtë lloj certifikimi dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.
- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 ose ekuivalent , pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

2.4.2 Per listen e meposhtme te mallrave:

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- Kabell TM 20kV sipas specifikimeve teknike
- Mufta 20kV sipas specifikimeve teknike
- Koka kablli TM dhe TU sipas specifikimeve teknike
- Shtylla betonarme sipas specifikimeve teknike
- Transformatore shperndarje sipas specifikimeve teknike
- Kabell TU ABC sipas specifikimeve teknike
- Kabell koaksial sipas specifikimeve teknike
- Kabine shtyllore sipas specifikimeve teknike
- Ndares te jashtem trefazor 10 kV sipas specifikimeve teknike
- Kabine parafabrikat sipas specifikimeve teknike

Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit, per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogut, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

ARGUMENTIM:

1. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standartet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së mallit të sipercituar.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të

sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

2. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Gjithashtu kriteri për përkthimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e blerësit. Përkthimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mallrave. Kjo ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

3. Kjo kerkese në lidhje me testimet zyrtare është në përputhje me piken 6/c, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Së pari, paraqitja e deshmive të testeve zyrtare siguron një burim të besueshëm të informacionit për cilësinë e mallrave. Testimet zyrtare janë kryer nga institucione të pavarura dhe të autorizuar ose nga prodhuesi i vetë mallrave, duke garantuar pavarësinë dhe besueshmërinë e rezultateve. Ky informacion është i rëndësishëm për AK për të siguruar që mallrat janë të pajtueshme me specifikimet dhe standartet e kërkuara.

Së dyti, kriteri për deshmitë e testeve zyrtare ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve. Duke përdorur informacionin e testeve zyrtare, AK mund të identifikojë përparësitë dhe mangësitë e çdo oferte potenciale. Duke kërkuar paraqitjen e deshmive të testeve zyrtare, AK mund të sigurojë që të gjithë operatorët ekonomikë kanë një mundësi të barabartë për të demonstruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të tyre. Kjo nxit konkurrencën e drejtë dhe siguron që oferta më cilësore të fitojë kontratën.

4. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqese vetedeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësive të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj të perputhet me mallrat e kerkuara.

Argumentim: Kërkesa në lidhje është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ne lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të paraqese vetedeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësive të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001 dhe objekti i saj të perputhet me mallrat e kerkuara, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Sjellim në vëmendje se bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Specifikimet teknike janë hartuar nga OSSH qender derguar me e mail ne Drejtorine Rajonale Tirane e OSSH sh.a.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.